

VENDIM
Nr.1035, datë 9.7.2008

**PËR CAKTIMIN E TARIFËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTEVE, NGA MINISTRIA E
PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, NË FUSHËN E
PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË TRANSPORTIT**

(ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1123, datë 13.11.2009)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për çmimet dhe tarifën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e tarifës 1 (një) euro për pagesën e licencave, që u jepen, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, subjekteve, persona, fizikë dhe juridikë, privatë, për ushtrimin e veprimtarive:
 - A. Në fushën e punimeve të ndërtimit:
 - i. Licencë profesionale për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim.
 - ii. Licencë profesionale për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e projektimit të veprave ndërtimore. *(ndryshuar me VKM nr.1123, datë 13.11.2009)*
 - B. Në fushën e transportit rrugor:
 - i) licencë për transport ndërkombëtar udhëtues;
 - ii) autorizim për shërbimin në një linjë të rregullt të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, me autobus;
 - iii) autorizim për shërbimin në një linjë të rregullt të specializuar në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, me autobus, vajtje-ardhje.
 - iv) Certifikatë për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve *(shtuar me VKM nr.1123, datë 13.11.2009)*
 - C. Në fushën e transportit detar:
 - i) leje për të vepruar në linja të rregullta ndërkombëtare detare;
 - ii) leje për ushtrimin e veprimtarisë së pilotimit dhe omerxhimit;
 - iii) leje për veprimtarinë e tërheqjes së mbeturinave të ngurta dhe vajore, në zonën portuale të Durrësit, Vlorës, Shëngjinit, Sarandës dhe në radat përkatëse;
 - iv) leje për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të shërbimit të pajisjeve të sigurimit të jetës në det.
 2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha